- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'ë realizojmë për AutoritetitKontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
  1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  2. Njoftimin e Kontrates;
  3. Kriteret e Vlerësimit;
  4. Kriteret e Përzgjedhjes;
  5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
  6. Preventivin e çmimeve
  7. Termat e referencës (nëse është rasti)
  8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
  9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

## 10. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	

**Shtojca2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVESIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëratë paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

**Oferta ekonomikee detajuar**

<b>Nr</b>	<b>Nr. Analizë</b>	<b>Përshkrimi i Punëve</b>	<b>Njësi</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi/Njësi</b>	<b>Cmimi total</b>
1.						
2.						
3.						
<b>Shuma</b>						
<b>Fondi Rezervë</b>						
<b>Shuma</b>						
<b>TVSH</b>						
<b>SHUMA TOTAL</b>						

**Nënshkrimi i ofertuesit** \_\_\_\_\_**Vula****Shënim:** Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_ ( e kërkuar në dokumentat e tenderit )



**Shtojca 3.**

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]  
 [ *Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve* ]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: [ *Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor* ]

Në emër të: [ *Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar* ]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [ *lloji i procedurës* ]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ *objekti* ]

Publikimi ( *nëse zbatohet* ): Buletini i Njoftimeve Publike [ *Data* ] [ *Numri* ] / *Nr. Referencës në faqen e APP-se*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [ emri i ofertuesit të siguruar ] ka derdhur një depozitë pranë [ emri dhe adresa e bankës ] / është garantuar pranë [ emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit ] me një vlerë prej [ monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra ] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [ *emri i autoritetit kontraktor* ] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoritetit kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [ *njoftimin e kontratës* ].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 4.**

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtjesit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit****Nënshkrimi****Vula**

**Shtojca 5.**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/ Kontraktor* ]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

**Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet** të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shtojca 6**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/ Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/ kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**GRAFIKUT I ZBATIMIT TËPUNIMEVE**

**Afatet e realizimit të punimeve:**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3. Afati i realizimit</i>				
<b>Nr</b>	<b>Përshkrimi i Punëve</b>	<b>Java 1/Muaji 1</b>	<b>Java 2/Muaji 2</b>	<b>Java 3/Muaji 3</b>	<b>Java 4/Muaji 4</b>	<b>Java 5/Muaji 5</b>
1.						
2.						
3.						
4.						

Shënim. Autoriteti/ kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

**Shtojca 7**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

## FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

➤ Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT** të pa ndryshueshme nga ato të miratuar nga APP në setin standart të dokumentave të tenderit.

### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

#### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është **2% e vlerës së fondit limit, vlera prej 40 733,3 ( dyzet mije e shtatëqind e tridhjetë e tre presje tre) lek.**

#### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

##### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

##### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të tre viteve të fundit financiare, lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se 35% të vlerës së përlogaritur të kontratës.

Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar mësipër. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**2.2.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të balanceve të viteve: (2018, 2019, 2020) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

**2.2.3** Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, pika 2.2.3 plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.*

*Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.*

#### **Shenim 2.2.2.1:**

Detyrimisht sipas përcaktimeve ligjore, kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

### **2.3. Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlogaritur të kontratës, ose/punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 80% vlera limit e kontratës që prokurohet

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- NP-3 A, Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
- NS-1 A, Punime per prishjen e ndertimeve
- NS-2 A, Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre
- NS-4 A, Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me lastic druri, lastic, metalik, dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese
- NS-14 A, Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë të punësuar të paktën:

#### **a. 1 (nje) inxhinier ndërtimi**

*Inxhinieri i ndërtimit duhet të jete i pajisur licence profesionale individuale "Inxhinier Ndërtimi" sipas lidhjes 2 te VKM nr. 759, date 12.11.2014 "Per licencimin profesional te individeve dhe subjekteve juridike qe do te ushtrojne veprimtari ne fushen e studimit dhe projektimit ne ndertim dhe mbikqyrjes e kolaudimit te punimeve te zbatimit ne ndertim", i ndryshuar të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, i cili duhet të figurojë si drejtues teknik në licencën e shoqërise, kontrate pune te vlefshme, librezë pune, CV.*

#### **b. 1 (një) teknik ndërtimi / Inxhinier ndërtimi**

*Tekniku i ndërtimit/Inxhinieri i ndërtimit duhet të jetë i pajisur me diplomë/kualifikime ekuivalente, nga institucionet e arsimit të mesëm profesional / arsimit të lartë të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në RSH",kontratë pune të vlefshme, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, librezë pune, dhe të figurojë në listëpagesa të paktën muajin e fundit.*

*Tekniku i ndërtimit / Inxhinieri i ndërtimit duhet të paraqesë deklaratë që nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe që do të jetë i disponueshëm gjatë gjithë zbatimit te kontratës.*

- *Në rast se inxhinieri i kërkuar në pikën 2.3.5 germa a, nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe është i disponueshëm në kantier gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, gjë të cilën ai do ta vërtetojë me paraqitjen e deklaratës, atëherë pika 2.3.5 germa b nuk është e detyrueshme të plotësohet.*

#### **c. 1 (një) punonjës i pajisur me certifikate te sigurise dhe mbrojtjes së shendetit në pune**

*Punonjësi të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit per "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit per pune", e dhene nga nje organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punës e vlefshme, librezë pune, dhe të figurojë në listëpagesa të paktën muajin e fundit.*

#### **d. 1 (një) teknik hidraulik ose Inxhinier Hidroteknik**

*Tekniku hidraulik duhet të jetë i pajisur me diplomë/kualifikime ekuivalente, nga institucionet e arsimit të mesëm profesional arsimit të lartë të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në RSH",kontratë pune të vlefshme, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, librezë pune, dhe të figurojë në listëpagesa të paktën muajin e fundit.*

#### **e. 1 (një) teknik elektrik ose Inxhinier Elektrik**

*Tekniku elektrik duhet të jetë i pajisur me diplomë/kualifikime ekuivalente, nga institucionet e arsimit të mesëm profesional / arsimit të lartë të akredituara të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në RSH",kontratë pune të vlefshme, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, librezë pune, dhe të figurojë në listëpagesa të paktën muajin e fundit.*

#### **f. 1 (një) elektrikist për ndërtesa**

*Elektracisti duhet të jetë i pajisur me diplomë/kualifikime ekuivalente, nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në RSH",kontratë pune të vlefshme, deshmi kualifikimi te sigurimit*



---

teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, libereze pune dhe të figurojë në listëpagesa të paktën muajin e fundit.

**h. 1 (një) hidraulik**

Hidrauliku duhet të jetë i pajisur me diplomë/kualifikime ekuivalente, nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”,kontratë pune të vlefshme, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, libereze pune dhe të figurojë në listëpagesa të paktën muajin e fundit.

**j. 2 (dy) suvatues**

Suvatuesi duhet të jetë i pajisur me diplomë/kualifikime ekuivalente, nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”,kontratë pune të vlefshme, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, libereze pune dhe të figurojë në listëpagesa të paktën muajin e fundit.

**k. 4 (katër) shtrues pllakash**

Shtruesi i pllakave duhet të jetë i pajisur me diplomë/kualifikime ekuivalente, nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”,kontratë pune të vlefshme, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, libereze pune dhe të figurojë në listëpagesa të paktën muajin e fundit.

**k. 2 (dy) Punëtor hidroizolimi**

Punëtori i hidroizolimit duhet të jetë i pajisur me diplomë/kualifikime ekuivalente, nga institucionet e arsimit të mesëm profesional të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”,kontratë pune të vlefshme, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, libereze pune dhe të figurojë në listëpagesa të paktën muajin e fundit.

**l. 4 (katër) bojaxhi për ndërtesa**

Bojaxhiu duhet të jetë i pajisur kontratë pune të vlefshme, libereze pune dhe të figurojë në listëpagesa të paktën muajin e fundit.

**m. 1 (një) drejtues kamioni**

Per shoferet leje drejtimi e vlefshme deshmi te kualifikimit te sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente, kontrate pune te vlefshme, libereze pune dhe te figurojne ne te figurojne ne list pagesen e muajit te fundit .

**n. 1 (një) drejtues eskavatori**

Per manovraret deshmit e aftesise profesionale nga DPSHTRR, te cilat duhet te jene te vlefshme dhe deshmi te kualifikimit te sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente,kontrate pune te vlefshme, libereze pune dhe te figurojne ne list pagesen e muajit te fundit .

**o. 1 (një) montues dyersh**

Per montuesit e dyerve duhet të jetë i pajisur kontratë pune të vlefshme, libereze pune dhe të figurojë në listëpagesa të paktën muajin e fundit.

**o. 5 (pesë) Punëtor krahu në ndërtim godinash**

Per punëtorër e krahut duhet të jenë të pajisur kontratë pune të vlefshme, libereze pune dhe të figurojë në listëpagesa të paktën muajin e fundit.

---

***Për plotësimin e kësaj kërkesë operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë personelin e mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, ndërsa përpara lidhjes/nënshkrimit të kontratës operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë për personelin e sipërcituar dokumentacion e lart përmendur.***

**2.3.4** Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet / kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

<b>Makinerite</b>	<b>Njesia</b>	
Kamioncine 1-3.5 ton	cope	Ne pronesi ose me qera
Kamion deri 5 ton	cope	Ne pronesi ose me qera
Skele inventar	m2	Ne pronesi ose me qera
Pompe suvatimi	cope	Ne pronesi ose me qera
Minieksavator	cope	Ne pronesi ose me qera
Vinc kulle deri 5 ton	cope	Ne pronesi ose me qera

***Për plotësimin e kësaj kërkesë operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë mjetet e mësipërme në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, ndërsa përpara lidhjes/nënshkrimit të kontratës operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë për mjetete sipërcituara dokumentacionin e mëposhtëm:***

- a) Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme), çertifikatën e për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).
- b) Për mjetet e siguruar me qira, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme), *çertifikatën e për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme)*. duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qirase/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike kur janë në pronesi duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si kontratën e blerjes ose dokumentin e çdoganimit, faturat, ndërsa kur janë marrë me qira, kontrate qiraje, fatura tatimore.
- d) *Per secilin nga mjetet e kerkuara te paraqiten foto ku te jete e dukshme targat e mjeteve.*
- e) Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkrahura, do të jenë të angazhuara vetëm në këto kontrate. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë

disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

Mjete mbrojtese		
Kokore	25 cope	Ne pronesi ose me qera
Fikse Zjarri	2 cope	Ne pronesi ose me qera
Tabela Sigurimi Teknik	2 cope	Ne pronesi ose me qera
Jelek	25 cope	Ne pronesi ose me qera
Kuti Ndhime e shpejt	1 cope	Ne pronesi ose me qera

### 2.3.5 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme:

- ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit të cilesisë) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- ISO 45001 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_

deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigja</b>
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

**B: DEKLARATË**

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik

(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Punët/ pajisjet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet, mbi kapacitetin e, të cilave do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

---

<p>persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>	
--	--

**B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

--



Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;	Po [ ]
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po [ ]
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	Po [ ]
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	Po [ ]
5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:  a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti Kontraktor;  b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .	Po [ ]
6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	Po [ ] Jo [ ]
7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit).	Po [ ] Jo [ ]

<p>8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :</p> <p>a) çmimet;</p> <p>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> <p>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</p> <p>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</p>	Po [ ] Jo [ ]
<p>9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose kërkesat specifike të punëve shërbimeve/apo pajisjeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.</p>	Po [ ] Jo [ ]
<p>10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.</p>	Po [ ] Jo [ ]

### C: DEKLARATAMBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:</p> <p>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p>
<p>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit</li> </ul>

është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

#### D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:	
1. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.	Po [ ] Jo [ ]
2. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.	Po [ ] Jo [ ]
3. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe	Po [ ] Jo [ ]

Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.	

### Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

#### A: DEKLARATË “Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [ ] Jo [ ]

#### B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:  Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me	<b>Punonjës</b>  Po [ ] Jo [ ]  Nëse, po, numri i punonjësve:

